



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 15949 prot.

Shkodër, më 05.08. 2025

**VENDIM
Nr.52, datë 04.08.2025**

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E 89.65% TË AKSIONEVE
TË SHOQËRISË “DUHAN CIGARE” SH.A, NGA MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 04.08.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, dhe nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; të Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”; si dhe bazuar në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e 89.65% të aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vijimin e procedurave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër të kërkesës për ndryshimin e pronësisë së pasurisë së sipërpërmendur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 25 vota

Vota Pro	25
Vota Kundër	9
Vota Abstenim	1
Zbardhur me datë	05.08.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

